

Nr. 179/7 Prot  
Nr. 0099-21 Dosje

Tiranë më, 24/11/2021

**URDHËR  
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

**Drejtuar:** Qendra Kombëtare e Biznesit

**Adresa:** Tiranë

**Per dijeni: Debitorit :** Shoqëria "I.N.C.A NORD FISH" sh.p.k Nipt K77620501D

**Adresa:** Lagjia Skëndërbej, Bashkia Lezhë

**Per dijeni: Debitorit :** Enio Alban Zusi Dtl.11/09/1995

**Adresa:** Rruga "Bajram Curri", Pall.21, H.43, Ap.19, Nj.Adm 5, Tiranë

**Kreditor :** Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**Adresa:** Rruga "Muhamet Gjollësja", pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Tiranë.

Pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "BESA" sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 0099-21 regj dhe me palë:

**Kreditor :** Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**Debitorit :** Shoqëria "I.N.C.A NORD FISH" sh.p.k Nipt K77620501D

Enio Alban Zusi Dtl.11/09/1995

**Objekti :** Likuidim gjobe

**KONSTATOVA:**

Për titullin ekzekutiv "Vendim Gjobe Nr.166, datë 17.06.2020", është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit "Vendimi Nr.1618 (31134-04034-80-2021) Regj.Them, datë 13/07/2021 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë", me palë kreditore Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe palë debitore Shoqëria "I.N.C.A NORD FISH" sh.p.k dhe Enio Alban Zusi.

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", dhe nenit 39 të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative".

**URDHËROJ:**

1. Vendosjes e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit Shoqëria "I.N.C.A NORD FISH" sh.p.k Nipt K77620501D dhe Enio Alban Zusi i dtl.11/09/1995, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenet 606 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Zyra e Përmbarimit Privat "BESA" sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Klodiana TABAJ